



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta – Ministry of Culture, Youth and Sport

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet

MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

dhe

KOMUNËS SË DEÇANIT

Prishtinë 2023

1. QËLLIMI I MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT

Qëllimi i këtij Memorandum Bashkëpunimi është ndërtimi i kornizës së bashkëpunimit për mbështetje financiare nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për fazën e fundit të projektit të Qendrës Rinore në Deçan, faza e parë e të cilit ka qenë si pjesë e bashkëpunimit të lidhur në vitin 2019 përmes Memorandumit të Bashkëpunimit me numër protokoll 1571/2019 nënshkruar më 24.04.2019.

2. AUTORITETET

Qëllim i Memorandumit do të përmbushet nga:

- 2.1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; dhe
 - 2.2. Komuna e Deçanit.
- (në tekstin e mëtejshëm: Palët)

3. OBLIGIMET E PALËVE

3.1. Obligimet e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (më tutje MKRS).

MKRS merr përsipër këto obligime në raport me përmbushjen e qëllimit të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, si në vijim:

- 3.1.1. Ndan shumën në vlerë prej 220,000 € për fazën e fundit të projektit të Qendrës Rinore në Deçan, përcaktuar si në pikën 1 (një) të këtij Memorandumi.
- 3.1.2. MKRS merr përsipër zhvillimin e të gjitha procedurave të prokurimit për zbatimin e këtij memorandumi dhe arritjen e qëllimit të tij;
- 3.1.3. MKRS cakton një zyrtar si organ mbikëqyrës për monitorimin e kontratës, me vendim përkatës për implementimin e projektit;
- 3.1.4. Në bashkëpunim me komunën e Deçanit, përcjell fazën e fundit të projektit të Qendrës Rinore në Deçan.

3.2. Obligimet e Komunës së Deçanit

Komuna e Deçanit merr përsipër këto obligime në raport me përmbushjen e qëllimit të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, si në vijim:

- 3.2.1. Komuna e Deçanit cakton një zyrtar si organ mbikëqyrës për monitorimin e kontratës, me vendim përkatës për implementimin e projektit;
- 3.2.2. Siguron të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe pëlqimet tjera sipas legjislacionit në fuqi;
- 3.2.3. Në bashkëpunim me MKRS, përcjell zbatimin e fazës së fundit të projektit të Qendrës Rinore në Deçan.

4. ZBATIMI

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bashkëpunim me Komunën e Deçanit e përcjellin zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit dhe udhëzojnë për veprimet që duhet të

ndërmerren në implementimin e obligimeve dhe mbarëvajtjen e punimeve deri në momentin e realizimit të qëllimit.

5. MUNDËSIA E NDËRPRERJES SË MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT DHE RRETHANAT E PAPARASHIKUARA.

5.1. Ndërprerja e Memorandumit të Bashkëpunimit bëhet me marrëveshje ndërmjet palëve;

5.2. Nëse implementimi duhet të ndërpritet për shkak të ndodhive të fuqisë natyrore - *vis major* dhe rrethanave tjera të paparashikuara, palët do të vendosin bashkërisht dhe në konsultim me palët tjera relevante për veprimet që duhen të ndërmerren.

6. AFATI I REALIZIMIT

Afati i realizimit të qëllimit të këtij Memorandumi duhet të arrihet brenda vitit 2023.

7. AMANDAMENTIMI

Ky Memorandum Bashkëpunimi, mund të ndryshojë apo plotësohet sipas një marrëveshjeje me shkrim midis dy palëve. Përveç kësaj, çfarëdo aspekti apo kushti i caktuar që nuk është theksuar në këtë Memorandum Bashkëpunimi, në të ardhmen apo në një Amendament të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, të nënshkruar nga palët e kësaj marrëveshjeje, do të konsiderohen si të integruara në këtë dokument.

8. ZGJIDHJA NË RAST TË MOSMARRËVESHJEVE

Palët do të përpiqen që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me bisedime, mirëpo nëse nuk mund të arrijnë mirëkuptim, atëherë në rast të mosmarrëveshjes, kompetente për zgjidhjen e saj është Gjykata Themelore në Prishtinë.

9. HYRJA NË FUQI

Ky Memorandum i Bashkëpunimit është përpiluar në dy (2) kopje origjinale, ku secila palë do të ketë nga një kopje origjinale të nënshkruar.

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.


Hajrulla Ceku
Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit


Bashkim Ramosaj
Kryetar i Komunës së Deçanit

Nënshkruar më 02/03/2023
Prishtinë